



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 25.1.2023

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 25.1.2023, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 264/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik vlerësoi parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 21.11.2022, administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 5.12.2022, analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji përcjellë me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 15.12.2022, për të cilën mbajti dhe qëndrimin e tij me shkrim me parashtrimet e datës 21.12.2022, si dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, rreth materialit të datës 21.12.2022, të Komisionerit Publik dhe pyetjeve të Kolegjit, paraqitur në seancën e datës 19.1.2023.

Nga analiza e akteve si më sipër, Komisioneri Publik, për secilin shkak ankimi, vlerëson si vijon:

*1. Lidhur me shkakun ankimor: verifikimi i mundësisë financiare të babait të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, për dhurimin e shumave 6.000 euro dhe 4.000 USD, Komisioneri Publik, bazuar në pretendimet e subjektit mbi analizën financiare të kryer nga Kolegji, parashtrimet në seancat e datave 21.12.2022 dhe 19.1.2023, në raport me aktet në dosje të Komisionit, përgjigjet e pyetësorëve parë në harmoni edhe me transaksionet e llogarive bankare pranë \*\*\*, të personit të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\* dhe personave të tjerë të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\* dhe z. \*\*\*.\*\*\*, vlerëson se:*

1.1 Periudha e analizuar mbi mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\* për të krijuar e dhuruar shumat 6.000 euro dhe 4.000 USD, subjektit të rivlerësimit, duhet të jetë periudha shkurt 2005 - nëntor 2008, kohë gjatë së cilës janë krijuar dy depozitat në fjalë.

1.2 Marrë në konsideratë prapësimet gjyqësore të subjektit mbi të ardhurat e z. \*\*\*.\*\*\* nga shuma e maturuar e investimit në bono thesari prej 630.000 lekë dhe përdorimit *pjesor* të saj, për shlyerjen e huas ndaj z. \*\*\*.\*\*\*, nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të shtetasve të mësipërm, konstatohet se për periudhën objekt kontrolli (shkurt 2005-nëntor 2008), rezulton e depozituar në llogarinë bankare të z. \*\*\*.\*\*\* shuma prej 160.000 lekë, nga z. \*\*\*.\*\*\* (referuar përshkrimit të lëvizjeve në llogarinë bankare të z. \*\*\*.\*\*\*).

1.3 Për të njëjtën periudhë nga ana e personit të lidhur me subjektin, z. \*\*\*.\*\*\*, rezultojnë të depozituara në llogarinë bankare të z. \*\*\*.\*\*\* shumat totale prej 300.000 lekë, gjatë vitit 2005, 450.000 lekë, gjatë vitit 2006 dhe 900.000 lekë, gjatë vitit 2008, dhe 300.000 lekë, gjatë vitit 2009.

1.4 Nga verifikimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton se në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, shumat si më sipër janë përfshirë si një nga zërat e shpenzimeve vjetore.

1.5 Bazuar në sa më sipër trajtuar, Komisioneri Publik vlerëson se provohet pretendimi i subjektit, se detyrimi financiar i z. \*\*\*.\*\*\* kundrejt z. \*\*\*.\*\*\* duket të jetë shlyer nga personi i lidhur me subjektin, z. \*\*\*.\*\*\*, rrjedhimisht, gjendet i mbështetur dhe pretendimi i subjektit mbi konsiderimin si shpenzim të z. \*\*\*.\*\*\* për periudhën shkurt 2005 – nëntor 2008, për shlyerjen e detyrimit ndaj z. \*\*\*.\*\*\*, i shumës prej 120.000 lekë.

1.6 Për sa i përket pretendimeve të tjera të subjektit, mbi të ardhurat e z. \*\*\*.\*\*\* nga qiraja (në vlerën 220.000 lekë), rishikimin e shpenzimeve të jetesës dhe mospërfshirjen në analizën e periudhës së investimit në shumën 270.000 lekë, të trajtuara dhe në parashtrimet e seancës së datës 21.12.2022, Komisioneri Publik i gjen ato të pambështetura.

1.7 Për sa më sipër argumentuar, nga reflektimi në analizën financiare të shumës së maturuar nga bonot e thesarit, prej 630.000 lekë, në të ardhurat e periudhës së analizuar, dhe shpenzimit për shlyerje huaje për të njëjtën periudhë, në shumën 120.000 lekë, përsëri do të rezultonte me pamundësi financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, në shumën – 226.516 lekë.

**2.** *Lidhur me shkakun ankimor mbi vlerësimin e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për t'i dhënë hua personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën totale 45.000 euro në vitin 2009, Komisioneri Publik, sikundër është shprehur dhe në parashtrimet e datës 21.12.2022, ka vlerësuar se:*

2.1 *Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi të ardhurat e pretenduara të përfituara nga personi tjetër i lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, bazuar në kontratat e qirasë të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, të periudhës 1996, 1999, 2000 dhe 2001<sup>1</sup>, edhe pas depozitimit të akteve në seancën e kaluar dhe administrimit të prapësimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik iu qëndron parashtrimeve të datës 21.12.2022, se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur për periudhën e analizuar.*

2.2 *Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi të ardhurat nga dhënia me qira e objektit banesë, të ndodhur mbrapa \*\*\*.\*\*\*, si dhe objektit (dyqan), me adresë në rruga “\*\*.\*.\*\*\*”, Komisioneri Publik iu qëndron parashtrimeve të datës 21.12.2022, duke konstatuar se nuk rezulton se nga ana e subjektit të jenë paraqitur akte për justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga këto marrëdhënie, rrjedhimisht, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>2</sup>, të*

---

<sup>1</sup> Kopje kontratë qiraje \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*/6.1996, ku z. \*\*\*.\*\*\* dhe z. \*\*\*.\*\*\* janë në cilësinë e qiradhënësit dhe përfitojnë ½ secili; Kopje kontratë qiraje, datë \*\*/8.1999, ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit; Kopje kontratë qiraje \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*/5.2000, ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit; Kopje kontratë qiraje \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*/12.2001, ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit.

<sup>2</sup> Referohuni vendimit (JR) 33/2022, të Kolegjit.

ardhurat e pretenduara si të përfituara nga këto marrëdhënie qiraje duket se nuk përmbushin kriterin e konsiderimit si të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

2.3 *Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi marzhin e fitimit nga të ardhurat nga aktiviteti tregtar i z. \*\*\*.\*\*\*, Komisioneri Publik iu qëndron parashtrimeve të datës 21.12.2022. Në mungesë si të paraqitjes së akteve justifikuese nga ana e subjektit mbi fitimin e pretenduar në masën 50% të qarkullimit vjetor, ashtu edhe të dhënave të konfirmuara mbi marzhin e fitimit të aktivitetit tregtar të personit tjetër të lidhur, mbetet për t'iu referuar standardit të mbajtur nga ana e Komisionit e të pranuar në vendimin e konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me llogaritjen e marzhit të fitimit në masën 20% të qarkullimit vjetor, çka do të rezultonte në pamjaftueshmëri financiare të personit tjetër të lidhur, \*\*\*.\*\*\*, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme huan e deklaruar dhënë bashkëshortit të subjektit.*

2.4 Në përfundim, në vlerësim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me burime të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për një diferencë negative prej – 3.125.100 lekë.

3. *Lidhur me shkaku ankimor mbi mundësitë e personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për të dhuruar shumat e deklaruara ndër vite nga ana e subjektit, Komisioneri Publik, sikundër ka parashtruar dhe gjatë seancës së datës 21.12.2022, vlerëson se, pas analizimit të akteve të depozituara nga subjekti mbi investimet e familjes Toro, subjekti i rivlerësimit ka provuar burimet e ligjshme të dhuruesve (familjes Toro), për të dhuruar shumat e deklaruara për periudhën 2010-2016.*

4. *Lidhur me shkaku ankimor mbi burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për të dhuruar, gjatë viteve 2008-2016, shumat e deklaruara fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, gjithsej në shumën prej 950.000 lekë, Komisioneri Publik, sikundër është shprehur dhe në parashtrimet e datës 21.12.2022, ka vlerësuar se nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike të datës 5.12.2022, rezultuan rrethana që dëshmojnë një marrëdhënie të ngushtë të karakterit familjar të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, me z. \*\*\*.\*\*\*, me rrjedhoja krijimin e depozitave pranë \*\*\*-së, duke u çmuar se plotësohen nevojat e hetimit për këtë shkak ankimi.*

5. *Lidhur me shkaku ankimor: “Analizë financiare e mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003 – 2016”, Komisioneri Publik, fillimisht, vlerëson të ndalet në pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në prapësimet e datës 19.1.2023, paraqitur pranë Kolegjit, mbi tejkalimin nga ana e Komisionerit të objektit të ankimit kundër vendimit nr. 264, të datës 17.6.2020.*

5.1 Në ankimin e datës 5.10.2020, kundër vendimit nr. 264, të datës 17.6.2020, të Komisionit, në prg. 28.1 të tij, Komisioneri Publik, ndër të tjera, si një nga shkaqet e ankimit, ka parashtruar nevojën e hetimit nga ana e Kolegjit dhe kryerjes së analizës tërësore financiare, pasi ajo e kryer nga ana e Komisionit nuk është e plotë dhe nuk është hetuar për të gjitha elementet e saj, duke vlerësuar se, përveç sa konstatuar nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve në llogaritë bankare në vitet 2012 dhe 2015, nga vlerësimi i të dhënave rezulton se në gjendjen që janë aktet, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet edhe për vitet 2014 dhe 2016, duke sjellë në vëmendje të Kolegjit këtu se, në zërin e shpenzimeve të kësaj analize financiare, do të duhej të gjenin pasqyrim, po ashtu, edhe ato shpenzime që lidhen me shpenzimet e kryera për udhëtime, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në pyetësorët përkatës dhe të dhënat e sistemit TIMS.

5.1.1 Në përfundim të ankimit, Komisioneri Publik ka kërkuar kryerjen e një hetimi të plotë nga ana e Kolegjit me qëllim: (i) rishikimin e metodologjisë së kryerjes së analizës financiare për personat e cilësuar si “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit; dhe (ii) në varësi të rezultateve, kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit për periudhën e deklaramit.

5.1.2 Në parashtrimet e depozituara në Kolegj, në datën 5.12.2022, në paragrafin 11.1, Komisioneri Publik ka ritheksuar nevojën e hetimit për dy nga zërat përbërës të analizës financiare, konkretisht, zërin të ardhura nga paga e personit të lidhur dhe zërin shpenzime udhëtimi. Pikërisht, shënimi nr. 26, në parashtrimet e Komisionerit Publik, të datës 5.12.2022, është vendosur në funksion të togfjalëshit: “*nuk është hetuar për të gjitha elementët e saj*”.

5.1.3 Me të njëjtin interpretim të këtij shkak të ankimit, Kolegji, në analizën e kryer sipas kërtimeve të Komisionerit Publik, në funksion të ankimit dhe me qëllim kënaqjen e nevojave të hetimit, ka rivlerësuar të gjithë zërat përbërës në hartimin e analizës tërësore financiare për vitet e pretenduara nga Komisioneri Publik.

5.1.4 Rrjedhimisht, nga sa më sipër parashtruar, pretendimi i subjektit mbi shkakun e ri të shtuar nga Komisioneri gjatë trajtimit të çështjes në Kolegj, gjendet i pabazuar dhe, si i tillë, nuk duhet të merret në konsideratë nga Kolegji, pasi ky shkak nuk përbën shtim të objektit të ankimit.

5.2 Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi zërin: “*Të ardhura nga paga e personit të lidhur*”, të trajtuara në prapësimet e datës 19.1.2023 pranë Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe në referencë të llogaritjeve të kryera nga ana e Kolegjit në analizën paraprake, vënë në dispozicion të palëve, në asnjë nga variantet e konsiderimit të të ardhurave të pretenduara nga pagat, edhe në variantin më garantist për subjektin e rivlerësimit, kjo e fundit nuk provoi mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve, investimeve dhe kursimeve për periudhën e analizuar, për një diferencë negative prej – 999.957 lekë.

5.2.1 Ndërkohë, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën financiare të kryer nga ana e Kolegjit dhe aktet në të cilat kjo analizë është bazuar, pretendimet e subjektit në seancën e datës 19.1.2023, në harmoni me aktet në të cilat këto pretendime mbështeten, konstaton se: (i) nga verifikimet e deklaratave periodike vjetore të periudhës 2012 – 2016, nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga ana e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit të ardhura nga paga, por është deklaruar vetëm totali i qarkullimit vjetor, me përshkrimin: *të ardhura nga puna si avokat*; (ii) në pasqyrat financiare të depozituara në dosje të hetimit të Komisionit, për vitet 2011 dhe 2012, nuk evidentohet kontabilizimi i pagave në zërat respektiv; (iii) nga verifikimi i llogarive bankare personale<sup>3</sup> të personit të lidhur, evidentohen vetëm dy transaksione, të cilat mbajnë përshkrimin: *tërheqje page* nga ana e personit të lidhur; (iv) aktet e depozituara në dosje të hetimit administrativ nga organet përgjegjëse<sup>4</sup> referojnë të dhëna të ndryshme (*në njërin nga këto akte rezulton se zëri “pagë” nga personi i lidhur është deklaruar në vlerën zero*) dhe në asnjë rast nuk provojnë masën e pagës reale të përfituar nga personi i lidhur nga aktiviteti; (v) referuar akteve në dosje, lëvizjeve të llogarive bankare, si dhe vetë pretendimeve të subjektit, nga llogaritë bankare të personit të lidhur rezultojnë tërheqje fondesh apo kalime nga llogaria në cilësinë e “personit fizik” në llogarinë personale të

<sup>3</sup>Referuar Udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, të ndryshuar, pika 6.1/k, detyron bizneset me qarkullim vjetor deri në 8 milionë lekë dhe që i nënshtrohen pagesës së tatimit të thjeshtuar të fitimit, të kalojnë pagat dhe shpërblimet/ardhurat nga punësimi nëpërmjet sistemit bankar. Gjithashtu, sipas nenit 53 të ligjit nr. 136/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, dt. 12.7.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë i ndryshuar”.

<sup>4</sup> Në rend kronologjik, shkresa nr. \*\*\*/\*\* prot., dt. \*\*.11.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; shkresa nr. \*\*\*/\*\* prot., dt. \*\*.6.2017, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; shkresa nr. \*\*\*/\*\* prot., dt. \*\*.10.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ku rezulton se pagat për periudhën dhjetor 2014 – dhjetor 2018, janë regjistruar në vlerën zero.

personit të lidhur, në shumën të ndryshme, të cilat duke qenë se e tejkalojnë masën e pagave të deklaruara pranë sigurimeve shoqërore dhe organeve tatimore për efekt llogaritje kontributesh, nuk mundësojnë përcaktimin e qartë të shumës reale të përfituar në formë page dhe shumës së shpenzuar për mbulimin e shpenzimeve e tjera të aktivitetit si “person fizik”.

5.2.2 Në këto rrethana, deklaratat dhe të dhënat kontradiktore, bëjnë të pamundur identifikimin real të pagës së pretenduar, me qëllim përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të viteve 2012, 2014, 2015 dhe 2016, çka do të thellonte pamjaftueshmërinë financiare përtej vlerës së llogaritur me një diferencë negative prej – 999.957 lekë, të pasqyruar në analizën paraprake të Kolegjit.

5.3 *Lidhur me pretendimin mbi shlyerjen e huas personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*,\*\*\*, gjatë vitit 2012, për shumën 3.000 euro, pas verifikimit të lëvizjeve të llogarive bankare, përsëri do të çonte në pamjaftueshmëri financiare të burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e vitit 2012.*

5.4 *Lidhur me pretendimet e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe personave të lidhur me të për periudhën e analizuar, Komisioneri Publik ka trajtuar gjerësisht, gjatë seancës së datës 21.12.2022, qëndrimin e tij mbi vlerësimin për llogaritjen nga ana e Kolegjit të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën në fjalë, duke ritheksuar edhe njëherë rishikimin e kostove të udhëtimit sipas konfirmimeve nga agjencitë e udhëtimit, vlerësuar këto akte në harmoni me deklaratat periodike vjetore, me përgjigjet e Pyetësorit nr. 1 të hetimit dhe me të dhënat e sistemit TIMS. Pretendimet e subjektit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga shtetasit \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, për sa trajtuar gjerësisht edhe në parashtrimet e seancës së datës 21.12.2022, bien në kundërshtim me deklaratat e subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratat gjatë hetimit administrativ në Komision.*

5.5 Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi disponimin në vitin 2012 të shumës 1.000 euro *cash*, si diferencë e mbetur nga dhurimi i shumës 10.000 euro të një viti më parë, Komisioneri Publik, në referencë të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit mbi deklarimin e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, si dhe bazuar në deklaratat e subjektit në DV-2012, e gjen këtë pretendim të pabazuar.

5.6 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se, në mbështetje të sa trajtuar më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë më burime nga të ardhura të ligjshme, shpenzimet dhe investimet e viteve 2012, 2014, 2015 dhe 2016.

## **6. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

Duke përfunduar për sa parashtruar, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 264, datë 17.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**